Kronikë

Plagosja e 51-vjeçarit me 5 plumba në Mirditë për shkak të konflikteve të vjetra! Arrestohet autori, ndalohet edhe vëllai binjak, e ndihmoi të fshihej

Flonin Gjoka është 21-vjeçari i arrestuar si autor i dyshuar i plagosjes së 51-vjeçarit Marin Prenga në Fan të Mirditës. Së bashku me të është ndaluar edhe vëllai i tij binjak, Altin Gjoka, pasi e ka ndihmuar që të fshihej pas krimit.

■ Detaje nga plagosja në Mirditë/ Ndalohet vëllai binjak i autorit! Del FOTO e pistoletës që përdori 21-vjeçari
■ Plagosja e Marin Prengës, autorët me motor qëlluan drejt lokalit! Brenda ishin 2 policë

HOROSKOP!

Elvis Hila
2 Korrik, 08:05 | Përditësimi i fundit: 2 Korrik, 09:55

Një 51-vjeçar u plagos me armë zjarri në Mirditë, ndërsa disa orë më vonë policia arriti të indentifikojë dhe arrestojë autorin. Ngjarja ndodhi mes orës 22:00 të mbrëmjes të së premtes në autostradën Milot-Kukës pranë një pike karburanti në zonën e Fanit. Objektivi i sulmit me armë ishte 51-vjeçari **Martin Prenga** banues në Klos të Mirditës. Ndaj tij u qëllua 5 herë me pistoletë teksa ishte në ambientet e jashtme të karburantit, por fatmirësisht vetëm 1 nga plumbat e preku në këmbë.

Brenda lokalit ku ndodhej karburanti ishin dy oficer civil policie të cilët kanë reaguar shpejt dhe nxjerre armët, duke trembuar autorin i cili u largua pa mundur të ekzekutoi 51-vjeçarin Martin Prenga. I plagosuri fillimisht u dërgua për ndihmë mjekësore në Spitalin e Mirditës dhe më pas drejt Spitalit të Traumës në Tiranë, nga ku mësohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë pas ngjarjes policia arriti të identifikojë autorin dhe arrestoi atë 5 orë më vonë.


LEXO EDHE:
Shpërthimi me tritol në ishull Shëngjin, VIDEO kur dy autorët me motor i vënë lëndën plasëse servisit dhe largohen me shpejtësi

Ai është tëhetasi Florian Gjoka 21-vjeç banues në Mirditë si dhe është procedusr penalisht në gjendje të liré vëllai i tij binjak, shtetasi Altin Gjoka, i cili ka ndihmuar autorin e plagosjes të largohej me motor nga vendi i ngjarjes dhe të fshihet. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e zjarrit pistoletë e dyshuar e përdorur nga autori, ndërsa vijojnë hetimet për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësinë e të gjithë personave të përfshirë në këtë konflikt, i cili e kishte zanafillën kohë më parë dhe ka agravuar deri në përdorimin e armës së zjarrit.

Materialet procedurale ku referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasja me paramendim" e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", në ngarkim të shtetasit Florian Gjoka dhe "Përkrahja e autorit të krimit", në ngarkim të shtetasit Altin Gjoka.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 09:22

Detaje nga plagosja në Mirditë/ Ndalohet vëllai binjak i autorit, e ndihmoi të fshihej pas krimit! Del FOTO e pistoletës që përdori 21-vjeçari



Detaje të reja kanë dalë në dritë nga plagosja në Mirditë. Mësohet se i ndaluar nga policia është edhe vëllai binjak i autorit i cili e ka ndihmuar që të fshihet pas krimit. Ndërkohë, policia ka shpërndarë edhe foton, e pistoletës që është përdorur nga 21-vjeçari me të cilin ka qëlluar ndaj 51-vjeçarit.

> *"Mirditë/Policia zbardh dhe dokumenton ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e djeshme, në Fan, ku mbeti i plagosur me armë zjarri shtetasi M. P. Arrestohet autori i dyshuar i plagosjes, procedohet në gjendje të liré vëllai i tij, i cili e ndihmoi të largohej nga vendi i ngjarjes.*
>
> *Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë e dyshuar e përdorur për plagosjen. Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve ndaj Jetës dhe Lirisë së Personit në DVP Lezhë, në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Mirditë, falë veprimeve të shpejta e profesionale hetimore, duke administruar çdo provë në vendin e ngjarjes dhe pamje filmike, si dhe duke shoqëruar e pyetur disa shtetas, në cilësinë e personave që kanë dijeni për mathanë e ngjarjes, kanë bërë të mundur zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e kaluar në Fan, Mirditë, ku mbeti i plagosur me armë zjarri shtetasi M. P., 51 vjeç, banues në Mirditë.*
>
> *Në përfundim të veprimeve procedurale është arrestuar shtetasi F. Gj., 21 vjeç, banues në Mirditë, si dhe është procedusr penalisht në gjendje të liré vëllai i tij, shtetasi A. Gj., 21 vjeç, banues në Mirditë. Në autostradën Rrëshen-Kukës, në Fan, Mirditë, shtetasi F. Gj. ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasin M. P., i cili si pasojë ka marrë plagë në këmbë dhe ndodhet në Spitalin e Traumës, jashtë rrezikut për jetën.*
>
> *Pas ngjarjes, shtetasi A. Gj. e ka ndihmuar vëllanë e tij, shtetasin F. Gj. që të largohet nga vendi i ngjarjes dhe të fshihet. Vazhdojnë hetimet për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësinë e të gjithë personave të përfshirë në këtë konflikt, i cili ka agravuar deri në përdorimin e armës së zjarrit. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e zjarrit pistoletë e dyshuar e përdorur nga autori. Materialet procedurale ku referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasja me paramendim" e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", në ngarkim të shtetasit F. Gj., dhe "Përkrahja e autorit të krimit", në ngarkim të shtetasit A. Gj", njoftoi Policia.*

Ora 08:45

Plagosja e 51-vjeçarit në Mirditë, autorët me motor qëlluan drejt lokalit! Brenda ishin 2 policë

Detaje te reja nga plagosja në Fan të Mirditës që ka ndodhur mbrëmjen e djeshme pranë një pike karburanti në rrugën e Kombit.

Autorët kanë qenë me motor dhe sapo janë afruar kanë qëlluar në drejtim të objektivit të tyre, Marin Prengës, i cili ndodhej në ambientet e jashtme të lokalit.

Në momentin e ngjarjes, në lokal kanë qenë dy oficerë policie, të cilët kanë dalë nga lokali dhe kanë nxjerë armët duke trembuar autorët, të cilët janë larguar me shpejtësi.

Marin Prenga dhe dy autorët, njëri prej të cilëve është identifikuar si Florjan Gjoka ishin banorë në të njëjtin fshat dhe kishin patur konflikte mes tyre.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: [shqiptarja.com](#) [ngjarje me armë zjarri](#) [Lezhë](#) [shqiptar](#) [mirditë](#) [fan](#) [marin prenga](#)

Komento

Ndalohet reeptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SONDAZH

Sondazhi i ditës:
Pritet konferenca e parë ndërqeveritare, mendoni se Shqipëria bëhet anëtare e BE në një kohë të shkurtër?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë



Mirditë/ Të shtëna me armë zjarri në Fan pranë Rrugës së Kombit, plagoset 51-vjeçari me precedent të mëparshëm penal! Autorët në kërkim

1 Korrik, 22:26

Kronikë



Tjetërsimi i pronave të lagunës së Kune Vain në Lezhë, gjykata lehtëson masën për kryeplakun e fshatit Gryk Lumi

Elvis Hila
1 Korrik, 18:34

Kronikë



Shpërthim me tritol në servisin e makinave gjatë natës në Lezhë! Lënda plasëse u hodh nga dy persona, ishin me motor! Djali i pronarit: Nuk kemi konflikte (VIDEO)

1 Korrik, 09:24

Kronikë



Aksident i rëndë në Lezhë, mjeti 'bëhet copash', përplaset me murin rrethues të një baneseë! Plagoset rëndë shoferi dhe 12-vjeçari (VIDEO)

Elvis Hila
30 Qershor, 17:00

Kronikë



Plagosi me thikë 2 bashkëkombasit dhe një italian, merr fund arratia e 52 vjeçarit shqiptar

30 Qershor, 16:33

Kronikë



Vettingu, KPK konfirmon në detyrë gjyqtaren e Lezhës! Elsa Ulliri rezultoi e pastër në të tre kriteret e verifikuara

Elvis Hila
30 Qershor, 09:29

Sociale



Lezhë/ 600 banorë në Gocaj 'thahen' për ujë të pijshëm! Banorët: Marrim bidonët dhe shkojmë në fshat tjetër

Elvis Hila
29 Qershor, 17:26

Kronikë



Tjetërsimi i lagunës, prangoset kryeplaku i Gryk Lumit! Sekuestrohen dokumente te falsifikuara

Elvis Hila
29 Qershor, 12:32

Kronikë



Lezhë/ Burri mbolli parcelën me drogë, grusja e mbron duke ia hedhur fajin vëllezërve: Ajo duhet ta këtë bërë me doemos

28 Qershor, 16:40

Kronikë



Aksident i rëndë në Lezhë, mjeti përplaset me furgonin e mallrave! Plagosen 3 persona, 2 prej tyre në gjendje të rëndë (VIDEO)

27 Qershor, 17:16

Kronikë



Sherri për shelzogët në Shëngjin! Nën hetim edhe vëllai i Armanda Markut, goditi gruan e Paris Dedës

27 Qershor, 14:57

Kronikë



Sherr mes shqiptarëve në Itali, kapshtari i armatosur troket në derën e shtëpisë së bashkatdhetarit dhe qëllon 3 herë drejt tij

27 Qershor, 10:37

Lajmi i fundit



VIDEO/ Po tani kush e ka radhën pas Kardhiq-Delvinë?! Rama: Gati Bypass-i i Vlorës dhe nis puna për "Korridorin Blu"

2 Korrik, 16:22

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pautorizuar i kesaj faqeje